

SHIJOJE VERËN! POR MBROHU ME PRODUKTET GERNETIC!



*Të thuash që vera është duke trokitur, do të thotë se jeni shumë vonë për të riparuar dëmet që ka shkaktuar dielli i fortë veror. Sepse vera ka ardhur me kohë, është në kulmin e saj, ndaj teksa jeni duke e shijuar detin, rërën, plazhin, kujtohuni edhe të ruheni nga dëmet që shkaktton dielli. **Estetistja Maria** nga “**Joyel SPA**” jep disa këshilla me vlerë dhe sugjerimet ideale për produktet, të cilat nuk duhet t’i mungojnë ritualit tuaj të bukurisë*

Cilat janë dëmtimet më të mëdha që shkaktojnë rrezet e diellit gjatë verës?

Dëmtimet me të zakonshme e të lehta të rrezeve UV janë: skuqja, djegia, njollat kafe, dehidratimi etj. Në përgjithësi,

femrat mbi moshën 30-vjeçare vuajnë nga depigmentimi i lëkurës. Por rrezet e diellit mund të shkaktojnë dëme edhe më të mëdha e që rrezikojnë seriozisht shëndetin e përgjithshëm të njeriut, siç është kanceri i lëkurës, melanoma dhe plakja.

Atëherë cilat janë disa nga produktet që do t’u sugjeronit femrave për t’u mbrojtur kundër rrezeve të dëmshme të diellit veror?

T’i marrim problemet një e nga një. Për dehidratimin e lëkurës gjatë verës, do t’u këshilloja kremi “Marine Day Base”, një produkt, i cili mund të përdoret nga femrat mbi 30 vjeçe. Për t’u mbrojtur ndaj rrezeve të dëmshme, duhet të përdorni një “Melano 3” me SPF 23, i cili është ideal për lëkurë tepër të ndjeshme. Jep mbrojtje maksimale nga sëmundjet e shkaktuar nga dielli dhe të djegurat. Parandalon depigmentimin dhe mbron lëkurën nga dehidratimi. Kombinimi i elementeve aktive dhe rigjenerues të këtij kremi e mbron lëkurën dhe e ushqen atë.

Por si është radha e vendosjes të produkteve të tilla? A duhet të kenë femrat një rutinë bukurie, të cilën duhet ta ndjekin rregullisht?

Sigurisht. Kjo rutinë fillon që me zgjimin në mëngjes. Sapo të zgjoheni, duhet ta lani fytyrën me ujë të ftohtë. Uji i ftohtë ndihmon veçanërisht nëse zgjoheni me sy të ënjtur. Kujdes! Mos përdorni asnjëherë sapun nëse nuk keni informacionin e duhur se çfarë përbërësish duhet të ketë sapuni, në mënyrë që të mos ju dëmtojë lëkurën. Për një pastrim sa më të mirë të lëkurës së fytyrës përdorni një tonik ose qumësht. Ju këshilloj tonikun “Ser1” që jo vetëm kryen pastrim të thellë në lëkurë, por ruan nivelin e pH në lëkurë. Është hipoalergjik dhe i rekomandueshëm për të gjitha tipet e lëkurës. Për një pastrim të thellë të lëkurës, mund të përdorni edhe qumështin pastrues “Lysi”, i cili jo vetëm e pastron, por edhe e hidraton lëkurën. Vetëm pasi të keni një lëkurë të pastruar mirë, mund të vini kremi bazë “Marine Day Base” për moshat mbi 30-vjeçare ose kremi bazë “Prol1”, me SPF 5 me efekt rigjenerues, i rekomandueshëm për të gjitha tipet e lëkurës.

SPF 5? A nuk është ky krem me filtra të ulët mbrojtës?

Jo. Produktet që po ju këshilloj i përkasin “Gernetic”, gjigantit francez të prodhimit të kozmetikës, të cilët përdorin një standard tjetër të përcaktimit të filtrave mbrojtës. Nëse do ta përshtatnim

me standardin e SPF-ve, me të cilët janë mësuar zakonisht shqiptarët, atëherë duhet ta shumëzoni me dy, pra filtri mbrojtës në këtë rast është 10, i cili është i mjaftueshëm për një lëkurë fytyre normale dhe pa probleme.

Po nëse jemi shumë vonë për t’u ruajtur dhe jemi ekspozuar në diell pa u mbrojtur, cilat janë dëmet e shkaktuara dhe si mund t’i riparojmë?

Në raste të ekspozimit në diell pa kremi mbrojtës, krijohen probleme të depigmentimit dhe njollave të lëkurës. Në këtë rast këshilloj përdorimin e një kremi zbardhues, i cili vepron në lëkurë duke e dhënë një ngjyrë të njëtrajshme, por nuk e zhdok tërësisht problemin.

Por a ka rezultate të dukshme nëse përdoret ky lloj kremi dhe pas sa kohësh mund të vërehen me sy të lirë përmirësimet?

Kremi duhet të përdoret çdo mëngjes dhe rezultatet e para do të arrini t’i shihni pas një muaji. Por, për përmirësime të mëtejshme, këshilloj një trajtim në qendrën tonë. Nëpërmjet një trajtimi të mëtejshëm zbardhues me elektroda, të cilat i shkojnë më në thellësi, duke rregulluar melaninën e lëkurës së fytyrës, rezultatet janë akoma më të dukshme menjëherë pas dy seancave brenda një muaji.

Por për lëkurën e trupit çfarë lloj kujdesi duhet të tregojmë dhe cilat janë produktet të cilat duhet të përdorim?

Para se të shkoni në plazh, është e rëndësishme të përdorni eksfoliantë për të hequr qelizat e vdekura. Ideal për këtë rast do të ishte kremi eksfoliant “Ger Peel”. Pasi të keni bërë një eksfolim total të qelizave të vdekura dhe njollave të zeza, duhet që lëkurën ta mbron nga rrezet e dëmshme. Në këtë rast do të këshilloja “Gel Apres Soleil”, që qetëson ndjesinë e lëkurës së djegur, zbut sipërfaqen e skuqur dhe vepron thellë në lëkurë, duke riparuar qelizat e dëmtuara. Gjithashtu, ky xhel përmban substanca që hidraton lëkurën dhe parandalon plakjen.

